



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**C-II.-14-0156-C0001**

*Parashtruesja e ankesës:*

**M.V.**, Kralejë, Serbi

Kundër:

*Pala kundërshtare:*

Ndërmarrja Shoqërore “**D**”, Istog, e administruar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Agim Ramadani”, Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Teuta Ibrahim, më 27 shtator 2019, lëshon këtë:

**AKTVENDIM**

- 1. Procedura në këtë çështje juridike pezullohet, për arsye se Ndërmarrja Shoqërore “D”, Istog, është në likuidim.**
- 2. Çdo kërkesë për rihapje të një lënde të pezulluar do të trajtohet si lëndë e re dhe asaj do t’i caktohet numri i ri i lëndës.**
- 3. Lënda në fjalë e pezulluar për shkak të likuidimit të NSH-së konsiderohet lëndë e mbyllur.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Më 13 prill 2011 parashtruesja e ankesës **M.V.**, me adresë të vendbanimit në Kralejë, Serbi, ka paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Përmes këtij vendimi AKP-ja parashtruesja e ankesës ishte diskualifikuar nga lista e punëtorëve për të marrë në pjesë të 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së.

E pakënaqur me këtë vendim parashtruesja e ankesës paraqet këtë ankesë në të cilën thekson se në Ndërmarrjen Shoqërore “D”, Istog, ka punuar prej datës 23 maj 1977 gjer në muajin qershor të vitit 1999 kur për shkak të frikës e ka braktisur vendin e saj të punës dhe banesën.

Si pasojë, ankuesja thekson se është shkelur parimi i barazisë mbi bazat nacionale dhe se është diskriminuar në mënyrë direkte pasi që e drejta e saj në të ardhurat nga privatizimi i ndërmarrjes nuk iu është njohur edhe pse ka qenë punëtoare e kësaj ndërmarrjeje.

Ajo ende e konsideron veten punëtoare të kësaj ndërmarrjeje ngase askush nuk ka mundur t'i sigurojë asaj kthim të sigurt në vendin e saj të punës dhe lëvizje të lirë.

Në ankesë gjithashtu pohon se është diskriminuar për faktin se nuk ndodhet në listën e punëtorëve përfitues të pjesës së të ardhurave nga privatizimi i NSH-së.

Parashtruesja e ankesës në ankesë gjithashtu thekson se ka parashtruar kërkesë për pagat e papaguara por në shumë dhe periudhë të paspecifikuar.

Në fund, parashtruesja nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës kërkon që të detyrojë AKP-në për ta përfshirë në listën e punëtorëve legjitim për të fituar një pjesë të 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së, dhe të njeh të drejtën e saj për kompensimin e pagave të papaguara bashkë me fitimin e humbur.

Në mbështetje të pretendimeve të saj bashkëngjitur në ankesë ka dorëzuar provat vijuese:

- *Kopjen e vërtetuar të librezës së punës me nr. 95234, të hapur ë 23 maj 1977 (ende e hapur).*
- *Kopjen e vërtetuar të letërnjoftimit nr. 236879 të lëshuar më 24.01.2002.*

Më 30 tetor 2014 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës nxjerr aktgjykimin nr. SCCL-11-0012 përmes së cilit midis ankuesve tjerë aprovohet ankesa e ankueses M.V. (C0011) si e bazuar dhe e paditura AKP-ja urdhërohet që këtë ankuese ta përfshijë në listën përfundimtare të punëtorëve që gëzojnë të drejtën legjitime për një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH 'D' në Istog.

Në pikën V të këtij aktgjykim ceket se kërkesat lidhur me pagat e papaguara do të ndahen dhe do të regjistrohen me numra të rinj të lëndëve.

Më 9 shkurt 2016 Agjencia Kosovare e Privatizimit dorëzon në Dhomën e Posaçme mbrojtjen e saj kundër ankesës së parashtruar nga ankuesja M.V. në të cilën konsideron se kjo ankesë është e papranueshme dhe e pabazuar në ligj.

AKP-ja thekson se me vendimin e Agjencisë Nr. Ref. 234/2013 i datës 22.11.2013 ka filluar procedura e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore Kombinati Industrial Bujqësor 'D'.

Si provë bashkë me mbrojtje AKP-ja ka bashkëngjitur:

- *vendimin e Agjencisë Nr. Ref. 234/2013 i datës 22.11.2013 përmes së cilit ka filluar procedura e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore Kombinati Industrial Bujqësor 'D'.*

Agjencia në bazë të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, kërkon nga Dhoma e Posaçme që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të tyre të merr Aktvendim për të pezulluar së shqyrtuari padinë e paditëses M.V., kundër Ndërmarrjes Shoqërore "D", në Istog, derisa kjo NSH është në procedurë të likuidimit.

Zyra e Regjistrimit këtë lëndë e regjistron me numrin C-II-14-0156-C0001.

Për detaje tjera referimi bëhet tek dosja e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

### **NSH-JA ËSHTË NË PROCES TË LIKUIDIMIT.**

Pasi që as Dhoma e Posaçme e as Agjencia nuk e lejuan vazhdimin e veprimit të pezulluar, lënda në fjalë pezullohet.

Neni 22, paragrafi 2.6 i Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme parasheh që: *'kur ekzistojnë rrethana detyruese që arsyetojnë veprimin e tillë: pezullon lëndën apo procedurën apo zbatimin e një aktvendimi apo aktgjykimi, ose në përgjithësi, apo deri në një kohë apo ngjarje të caktuara'.*

Gjithashtu, Neni 10, paragrafi 1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në parasheh që: *'Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit'.*

Parashtruesja e ankesës është dashtë t'i drejtohej Komisionit të Likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore "D", në Istog, dhe ta dorëzonte kërkesën tek ai organ, pasi që Komisioni i Likuidimit të NSH-së është i vetmi entitet që ka të drejtë të kontrollojë, të trajtojë dhe t'iu përgjigjet padive/kërkesave në të cilat NSH-ja në likuidim thirret si e paditur.

Prandaj, u vendos si dispozitiv të këtij aktvendimi.

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Teuta Ibrahim** – Gjyqtare \_\_\_\_\_